



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Dragash
Opština Dragas
Municipality Dragas

Në bazë të nenit 133. Dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5.7.10 alineja 1.5 të Ligjit mbi Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme të Komunës (Ligji Nr.04/L-144), neni 10 alineja 1.5 dhe neni 20 alineja 11 UA i QRKosovës Nr.23/2013 për caktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të Komunës të dt.22.08.2013, si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Dragashit, e sipas Kërkesës së Këshillit të Xhamisë së f.Restelicë 02 Nr.463-85 i dt.18.05.2016 dhe Propozimit paraprak të Kryetarit të Komunës-Dragash, Kuvendit Komunal të Dragashit, në seancën e dt.31.05.2016, miraton këtë:

V E N D I M

I. NDAHET trolli nga prona komunale, për shfrytëzim në raste-nevoja të veçanta, me qëllim të investimit në sektorin energjetik-vendosja (dislokimi) i trafos elektrike në f.Restelicë, si vijon:

- Parc.kadastrale: **P-70604037-00931**
- Emërtimi i pronës: **Pronë shoqërore e Komunës së Dragashit**
- Sipërfaqja shfrytëzuese: **10 m/2**
- Arsyeja: **Dislokimi i trafos elektrike**
- Qëllimi: **Investimi në sektorin energjetik**
- Lloji i kohës së dhënies në shfrytëzim: **Afatgjatë**
- Çmimi fillestar: **Pa kompenzim**

II. Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdesen Kryetari i Komunës-Dragash dhe Drejtorati për Urbanizëm, Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash.

III. Vendimi hynë në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në protokolin e MAPL-së, si dhe publikimit në web-faqen e Komunës-Dragash.

A r s y e t i m

Në bazë të Kërkesës së Këshillit të Xhamisë së f.Restelicë 02 Nr.463-8539 të dt.18.05.2016 dhe përgjigjes së KEDS-it në Prizren, e për shkak të ndërtimit të xhamisë së re në f.Restelicë, pasi se pengon trafoja elektrike, është kërkuar dislokimi i trafos ekszistuese elektrike në lokcion tjetër e që është pronë e Komunës së Dragashit. Nevoja për dislokim është në interes të madh, si për Këshillin e Xhamisë, po ashtu edhe për vetë fshatin e Restelicës. Meqenëse bëhet fjalë për qëllim të investimit në sektorin energjetik, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.31.05.2016, vendosi si në pikën i të këtij Vendimi.

I dërgohet:

- KEDS-it Prishtinë(Prizren-Dragash),
- Këshillit të Xhamisë-Resticë,
- Drejtoratit për Urbanizëm, Kataster dhe mbrojtje të Mjedisit-Dragash, dhe
- Arkivit

01 Nr.06-8491/5
31.05.2016
D r a g a s h



Kryesuesi i Kuvendit:
Shaban Shabani